STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 24 tetor 2013

GUVERNATORI KUOMO NJOFTON $815 MILIONE PER FAZEN TJETER TE RIMEKEMBJES SE LONG AJLEND (LONG ISLAND) NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot $815 milionë në fonde për një sërë projektesh të rëndësishme të infrastrukturës për rimëkëmbjen dhe rindërtimin nga super stuhia Sendi (Sandy) në Long Ajlënd (Long Island). Këto projekte përfshijnë rihabilitimin e uzinave për trajtimin e ujrave të zeza, modernizimin e sistemit të shërbimeve të Long Ajlënd (Long Island), krijimin e mikro-rrjeteve për të përmbushur nevojat e energjisë dhe forcimin e urave të cënueshme ndaj motit të ashpër në të ardhmen.

"Gjatë vitit të kaluar, Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka dhënë fonde thelbësore për pronarët e shtëpive dhe bizneset e prekura nga super stuhia Sendi (Sandy), duke lejuar që shtëpitë të riparohen dhe dyert e bizneseve të rihapen," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Këto fonde janë hapi tjetër i madh në rimëkëmbjen e Long Ajlënd (Long Island). Jemi duke siguruar $815 milionë për qarqet Naso (Nassau) dhe Safolk (Suffolk) në mënyrë që të mund të ecin përpara me projektet e rëndësishme të punëve publike, rehabilimin dhe forcimin e infrastrukturës që pëson dëm të kushtueshëm dhe të rëndë në komunitete anembanë ishullit. Nga lehtësimi i uzinave të trajtojnë ujrat e zeza që u shërbejnë qindra mijëra shtëpive tek modernizimi i shërbimeve të Long Ajlënd (Long Island) dhe parandalimin e mungesave të energjisë tek fortifikimi i urave të cënueshme ndaj stuhive në të ardhmen, këto projekte do të rindërtojnë një Long Ajlënd (Long Island) më të qëndrueshëm për vite me rradhë. Jam i gëzuar që jap këtë ndihmë dhe mbetemi plotësisht të angazhuar për të ndihmuar që Long Ajlënd (Long Island) të arrijë një rimëkëmbje të plotë."

$697 milionë për rihabilitimin dhe lehtësimin e mjediseve të trajtimit të ujrave të zeza

Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të sigurojë $697 milionë për rehabilitimin dhe lehtësimin e mjediseve të trajtimit të ujrave të zeza në qarqet Naso (Nassau) dhe Safolk (Suffolk). Në Naso (Nassau), super stuhia Sendi (Sandy) dëmtoi rëndë Uzinën e Trajtimit të Ujrave të Zeza Bei Park (Bay Park Sewage Treatment Plant). Gjatë stuhisë, motorrët e sistemit kryesor të pompimit të uzinës u përmbytën nga 9 këmbë ujë dhe ujrat e zeza filluan të mblidheshin dhe të dilnin sipër në shtëpitë në zonën e poshtme dhe madje shpërthyen në rrugë në një lagje. Uzina u mbyll për më shumë se 50 orë dhe rreth 200 milionë gallona ujra të zeza të papërpunuara shkuan në kanale dhe tubacione. Përmbytja shkatërroi

sistemin elektrik të uzinës dhe kompromentoi shumë sisteme të tjera të rëndësishme.

Shteti (State) do të sigurojë $455 milionë për rehabilitimin dhe lehtësimin e uzinës së Bei Park (Bay Park). Shteti (State) është duke dedikuar fondet e Korporatës së Strukturave Mjedisore (Environmental Facilities Corporation) (EFC) që do të ripaguhen nga burime të ndryshme federale. Projekti, që do të administrohet nga Qarku Naso (Nassau County), përfshin:

- Ndërtimin e një sistemi të kanaleve, pritave dhe mureve të lëvizshëm të përmbytjeve përreth të gjithë uzinës për të siguruar mbrojtje ndaj stuhisë 500-vjeçare dhe përllogaritjes për rritjen e pritshme të nivelit të detit;
- Ngritjen dhe forcimin e Sistemit të Shpërndarjes të Uzinës Elektrike dhe riparimin e gjeneratorëve ekzistues për t'a hequr uzinën nga energjia e përkohëshme;
- Ngritjen dhe/ose forcimin e 57 stacioneve të pompimit që u shërbejnë një milionë banorëve për t'i mbrojtur nga përmbytjet;
- Ndërtimin e një linje më të madhe të grumbullimit të ujrave të zeza për të lejuar nivelet e rritura të vërshimit gjatë prurjeve të stuhisë; dhe
- Forcimin dhe zëvendësimin e pajisjeve për tharjen e pajisjeve dhe ndërtesave të dëmtuara gjatë Sendit (Sandy).

Për të parë imazhet e dëmit të uzinës së Bei Park (Bay Park) shkoni te:
http://www.governor.ny.gov/assets/documents/bay-park-dmg.pdf
http://www.governor.ny.gov/assets/documents/pump-station-dmg.pdf
http://www.governor.ny.gov/assets/documents/sandy-surge-12.pdf

Për të parë, shkoni te: http://www.governor.ny.gov/assets/documents/Document9.pdf.

Shteti (State) do të sigurojë $242 milionë për Strukturën e Trajtimit të Ujrave të Zeza të Bergen Point (Bergen Point Wastewater Treatment Facility) në Qarkun Safolk (Suffolk County) nëpërmjet fondeve të EFC-së që do të ripaguhen nga burime të ndryshme federale. Projekti do të administrohet nga lokalitetet. Ky fond do të zëvendësojë tubacionin e derdhjes në oqean të uzinës që kalon nën Grejt Sauth Bei (Great South Bay), duke e zgjeruar këtë tubacion nga 72 inç në 102 inç me material të përmirësuar dhe trajtimin e shqetësimeve se tubacioni mund të prishej nëse presioni rritej për shkak të vërshimit të madh nga stuhitë. Bergen Point ishte në gjendje të shmangte mbylljen për shkak të përgatitjes paraprakisht përpara Sendit (Sandy). Ajo u shërben 120,000 shtëpive dhe një stuhi tjetër e një shkalle të ngjashme do të ishte katastrofike pa këto përmirësime.

$51 milionë për sistemin e ri të administrimit të mungesave të energjisë të Long Ajlënd (New Long) për të rikthyer energjinë më shpejt

Shteti (State) do të sigurojë $51 milionë për të modernizuar në mënyrë të konsiderueshme sistemin e shërbimeve të Long Ajlënd (Long Island) duke lejuar që PSEG e Long Ajlënd (PSEG-Long Island) të

instalojë një sistem të ri të administrimit të mungesave të energjisë dhe përmirësime të tjera të teknologjisë që do të lejojnë ndërmarrjen e shërbimeve të identifikojë mungesat e energjisë dhe të rikthejë energjisë më shpejt. Hetimi nga Komisioni Morland mbi Përgatitjen dhe Reagimin ndaj Stuhisë të Ndërmarrjes së Shërbimeve (Moreland Commission on Utility Storm Preparation and Response) në mosarritjen nga LIPA që të rikthejë energjinë për disa javë veçanërisht rekomandoi krijimin e këtij sistemi, i cili do t'i jape Long Ajlënd (Long Island) një system mjaft të sofistikuar për të rregjistruar dhe administruar mungesat e energjisë.

Ky sistem i ri do të:

- Pakësojë kohëzgjatjet e mungesave të energjisë për shkak të rikthimit më të shpejtë mbështetur në parashikimet e vendndodhjes së mungesës së energjisë;
- Pakësojë mesataret e kohëzgjatjes së mungesave të energjisë për shkak të krijimit të përparësive;
- Përmirësojë kënaqësinë e klientëve për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit ndaj përparimit drejt rikthimit të energjisë dhe dhënies së kohërave më të sakta të vlerësuara të rikthimit;
- Përmirësojë transparencën duke siguruar infroamcion të saktë të mungesave dhe energjisë dhe të rikthimit; dhe
- Pakësojë shpeshtësinë e mungesave të energjisë për shkak të përdorimit të statistikave të mungesave të energjisë për bërjen e përmirësimeve të synuar të qëndrueshmërisë.

Gara prej $20 milionë për të krijuar mikro-rrjetin e Nasos (Nassau) dhe Safolkut (Suffolk)

Guvernatori njoftoi një garë prej $20 milionë për të krijuar mikro-rrjete të reja në qarqet Naso (Nassau) dhe Safolk (Suffolk). Fituesi i secilës garë do të marë $10 milionë.

Mikro-rrjetet janë sisteme të shpërndarjes në shkallë të vogël që lidhin dhe bashkërendojnë burime të shumta të shpërndarjes së energjisë (DER) në një rrjet duke u shërbyer disa ose të gjitha nevojave për energji të përdoruesve të vendosur aty pranë. DER përfshijnë burime të krijimit të shpërndarjes, teknologji të ruajtjes së energjisë dhe pajisje të kontrollit të sistemit të energjisë. Në një mikro-rrjet, DER të tillë janë lidhur së bashku me përdorues të shumtë vendorë të energjisë nëpërmjet strukturave të veçanta të shpërndarjes (d.m.th. kabllo dhe tubacione) dhe administrohen me sisteme të përparuara të infrastrukturës së matjes, komunikacioneve dhe kontrollit të automatizuar. Mikro-rrjetet mund të konfigurohen që të funksionojnë së bashku me sistemin e furnizimit me shumicë gjatë kushteve normale, por gjithashtu të shkëputen dhe të funksionojnë si një ishull i pavarur ose "ishullëzimi" në rastin e një defekti të furnizimit me shumicë. Mikro-rrjeti është evolucioni i natyrshëm i burimeve të shpërndarjes për rajonet ku sistemet e energjisë konvencionale nuk u shërbejnë konsumatorëve në mënyrë të qëndrueshme ose ku konsumatorë të rëndësishëm kanë nevojë për furnizimin të pandërprerë me energji gjatë emergjencave. Mikro-rrjetet gjithashtu mund të sigurojnë mbështetje për sistemet konvencionalë të energjisë që janë të kufizuar në përmbushjen e kërkesës.

$47 milionë për të forcuar 8 ura të cënueshme në Long Ajlënd (Long Island)

Shteti (State) është duke siguruar $47 milionë për të forcuar 5 ura në Naso (Nassau) dhe 3 në Safolk (Suffolk) që janë pranë ujit dhe kanë nevojë për të qënë të mbrojtura më mirë nëse godet një stuhi tjetër.

Urat në Naso (Nassau):

- Meadowbrook Parkway mbi False Channel, Qyteti i Hepsted (Town of Hempstead)
- Meadowbrook Parkway mbi Fundy Channel, Qyteti i Hepsted (Town of Hempstead)
- Meadowbrook Parkway mbi Sloop Channel, Qyteti i Hepsted (Town of Hempstead)
- Loop Parkway mbi Long Creek, Qyteti i Hepsted (Town of Hempstead)
- Southern State Parkway mbi Hempstead Lake, Qyteti i Hepsted (Town of Hempstead)

Urat në Safolk (Suffolk):

- Robert Moses Causeway mbi Fire Island Inlet, Qyteti i Islip (Town of Islip)
- Robert Moses Causeway (drejt jugut) mbi State Boat Channel, Qyteti i Islip (Town of Islip)
- Robert Moses Causeway (drejt veriut) mbi State Boat Channel, Qyteti i Islip (Town of Islip)

Shteti (State) vazhdon të japë ndihmë për Long Ajlënd (Long Island)

Njoftimi i sotëm i fondeve të reja për projekte të infrastrukturës publike është hapi i ardhshëm përpara në ndihmën që po i jepet Long Ajlënd (Long Island).

Deri tani, 3,969 pronarë të shtëpive janë miratuar për një shumë gjithsej prej $451 milionë në dhënie për strehim. Kjo përfshin

- Qarku Naso (Nassau County): 3,277 pronarë të shtëpive ($369 milionë)
- Qarku Safolk (Suffolk County): 692 pronarë të shtëpive ($82 milionë)

Pushtetet vendore në Long Ajlënd (Long Island) kanë marë $444 milionë në fonde të rimbursimit për riparime dhe shërbime të rimëkëmbjes. Kjo përfshin:

- Ndihmën Publike për Qarkun Naso (Nassau County): $316.3 milionë
- Ndihmën Publike për Qarkun Safolk (Suffolk County): $127.9 milionë

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian